REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
DREJTORIA E FINANCËS, SHËRBIMEVE
DHE PRITJES SË QYTETARËVE

SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVILË

DHE PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL PËR POZICIONIN E NIVELIT TË LARTË DREJTUES

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar si dhe të Kreut VIII dhe IX të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.118, datë 5.03.2014 "*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*" i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall procedurat e konkurimit për pozicionin:

Nd/Komisioner në Seksionin e Përgjithshëm. Kategoria e pagës I-4.

Pozicioni i mësipërm është i hapur për nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, për nëpunësit civil të kategorisë së mesme drejtuese (kategoria II-1), si edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e veçanta për pranimin në këtë kategori.

Data e fundit e dorëzimit të dokumentave për aplikim është dt. 16. 09. 2026

1. **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Nd/Komisioner në Seksionin e Përgjithshëm. Kategoria e pagës I-4.**

- Të trajtojë rastet që përcillen nga Komisioneri i Seksionit të Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm ose në mënyrë direkte nga Avokati i Popullit, sipas fushave dhe të drejtave që mbulon.
- Të propozojë rastet që mund të ndiqen me iniciativë, të bëra publike në median e shkruar apo atë vizive.
- Të kryejë inspektime pranë organeve të administratës publike qëndrore apo vendore, si dhe në terren, vendet ku ka sinjalizime/njoftime për shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.
- Të hartojë rekomandime për çështje të veçanta apo edhe rekomandime legjislative në rastet kur vetë ligji apo akti nënligjor përbën premisë për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

- Të monitorojë zbatimin e konventave të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, dhe të pregatisë informacione apo rekomandime për raportet periodike të monitorimit të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare.
- Të marrë pjesë në grupet e hartimit të raporteve të vecanta dhe ndjekjen në vijim të rekomandimeve të dala gjatë hartimit të tyre.
- Të jetë aktiv në mediat vizive dhe të shkruar me intervista apo edhe me emisione të drejtëpërdrejta mbi problematika të caktuara.
- Të zbatojë me përpikmëri urdhërat, udhëzimet dhe porositë që i jepen në vijë vertikale, sipas shkallës hierarkike nga varet.
- Të ushtrojë cdo kompetencë tjetër qe i jepet nga eprori, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion janë si më poshtë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë e mesme drejtuese (kategoria II-1);

- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

- Të ketë vlerësimin e fundit shumë mirë ose mirë;

3. Kriteret e veçanta që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion janë si më poshtë:

- Të zotërojë Diplomë të nivelit "Master Shkencor", në Shkencat Juridike/ Shkenca Ekonomike/ Shkenca Shoqërore. Edhe Diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat e marra në Universitetet jashtë vendit duhet të jenë të njehsuara nga Institucioni përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi
- Të zotërojë gjuhën angleze ose një gjuhë të BE-së.
- Të ketë të paktën mbi 5 (pesë) vjet përvojë në Administratën Publike nga të cilat të paktën 1 vit në nivel të mesëm drejtues (kategoria II-1).
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

4. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidati duhet të dorëzojë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore ose Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit dokumentat si më poshtë vijon:

- ✧ Letër motivimi për aplikim për vendin vakant, një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive për komunikim,
- ✧ Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard;
- ✧ Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- ✧ Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- ✧ Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- ✧ Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- ✧ Aktin e deklarimit të statusit të neëpunësit civil;
- ✧ Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- ✧ Vëretim nga Prokuroria e Rrethit ku banon, që nuk ka çështje në ngarkim të tij/saj;
- ✧ Vërtetim nga Gjykata e Shkallës së Parë ku banon, që nuk ka çështje në ngarkim tij/saj;
- ✧ Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- ✧ Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- ✧ Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Mosdorëzimi i plotë i dokementacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejpërsëdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit, brenda datës 16.09.2026

5. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit Sektori i Burimeve Njerëzore në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të Instutucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.
Kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar do të njoftohen me e-mail nga Sektori i Burimeve Njerëzore të Institucionit të Avokatit të Popullit, dhe kanë të drejtë të paraqiten prane saj për t'u njohur me arsyet e moskualifikimit. Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Sektori i Burimeve Njerëzore, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

6. Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

A. Kandidatët do të testohen në lidhje me njohuritë mbi:

1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
2. Ligji nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar;
3. Kodin e Procedurave Administative të Republikës së Shqipërisë;
4. Ligjin nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar;
5. Ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
6. Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
7. Ligjin Nr.7703, datë11.05.1993,"Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
8. Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Repubikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
9. Ligjin nr.10107, datë 30.3.2009" Për kujdesin shëndetësor në Repubikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
10. Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave peronale"
11. Konventa Për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
12. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Dhjetor të vitit 1948;
13. Parimet e Parisit për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut;
14. Parimet e Venecias për mbrojtjen dhe promovimin e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut;

B. Aftësitë për të:

- Menaxhuar situata emergjente;
- Menaxhuar situata të cilat nuk kanë qënë të parashikuara
- Marrë vendime mbi bazën e argumentave
- Shprehur opinion dhe argumenta në mënyrë të rrjedhshme dhe të sjellshme
- Respektuar të tjerët (kolegët, vartësit, qytetarët) dhe dëgjuar opinionet e tyre.
- Bashkëpunuar me kolegët, duke ndarë me ta informacionin dhe njohuritë e nevojshme
- Kominikuar procesin e vendimmarrjes bazuar në argumenta dhe analizë të pasojave.
- Ndërmarrë nisma të ndryshme strategjike dhe afatgjata brenda kompetencave të funksionitme qëllim përmbushjen e detyrave funksionale, përmbushjen e objektivave dhe përcaktimine rrugëve dhe hartimin e planeve për mënjanimin e risqeve në realizimin e tyre, duke shfrytëzuar kapacitetet njerëzore dhe material me kosto sa më të ulët dhe me rendiment maksimal.

7. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Faza e konkurimit konsiston në:

a) Vlerësimin e Jetëshkrimit (CV) të kandidatëve që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore; 10 pikë

b) Testimi me shkrim; 40 pikë

c) Intervista e strukturuar me gojë; 50 pikë

Testimi me shkrim dhe intervista me gojë synojnë vlerësimin e njohurive, të aftësive dhe cilësive të lidhura me fushën e kompetencës si më lart.

8. Komunikimi i rezultateve të konkurimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Sektori i Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al).

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në adresën:
Avokati i Popullit,
Bulevardi: "Zhan' Dark" nr. 2 – Tiranë.